



MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 193 Prot.

Tiranë, më 17.03 2015

**VENDIM Nr. 21, datë 11.03.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, të datës 11.03.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim projekti "Shëtitore e Bregut të Drinit-Lezhë, Faza II", paraqitur nga Bashkia Lezhë,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë projektin "Shëtitore e Bregut të Drinit-Lezhë, Faza II", paraqitur nga Bashkia Lezhë.
- II. Bashkia e Lezhës gjatë zbatimit të projektit "Shëtitore e Bregut të Drinit-Lezhë, Faza II", duhet të ruajë dhe integrojë, strukturat e murit të gjetura në zonën pranë urës së hekurit, buzë lumit Drin, në anën veriore të lagjes "Skënderbeg", me këtë projekt.
- III. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga arkeologët e DRKK- Shkodër, në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)